

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Maran kërkon seriozitet, Gjimshiti përqendrim 100%: Shqipëria synon fitoren ndaj San Marinos - Eurone ws Albania
ADRESA	https://euronews.al/maran-kerkon-seriozitet-gjimshiti-perqendrim-100-shqiperia-synon-fitoren-ndaj-san-marinos/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 19:12:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 18:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0dc497831ce547a3fb498b45e7f000c532fa9c2699fd5a7ee499fa5097dde5b6
TEKSTI	1283feff3ffd24e4fbb072f2e2242b9a192bd4f41bfd07624c76b32005ca8
PAMJA	4a98e64884287dfbbaa3c4440510f072b06b879aae1efb137ce11ce904341054

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	516f993a36ec6c830c8298b175be62d07438a40cd977786b1a4236b253e66f41
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/516f993a36ec6c830c8298b175be62d07438a40cd977786b1a4236b253e66f41>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Elbasan Britani e Madhe Rusia Lufta në Iran

LAJMI I FUNDIT | SPORT

Maran kërkon seriozitet, Gjimshiti përqendrim 100%: Shqipëria synon fitoren ndaj San Marinos

28 Shtator 2026 | 20:10

Kombëtarja shqiptare do të përballlet të martën me San Marinon, në ndeshjen e dytë të Ligës së Kombeve. Sfida do të luhet në transfertë në orën 20:45, ndërsa kuqezinjtë synojnë fitoren përballë përfaqësueses që mban vendin e fundit në renditjen e FIFA-s.

Në konferencën për shtyp para ndeshjes, trajneri Rolando Maran dhe kapiteni Berat Gjimshiti theksuan rëndësinë e përqendrimit dhe të qasjes së duhur ndaj një kundërshtari që në letër konsiderohet më i dobët.

Maran nënvizoi se Shqipëria duhet ta marrë me seriozitet përballjen, duke ruajtur përqendrimin, identitetin dhe ekuilibrin taktik. Trajneri italian theksoi gjithashtu rëndësinë e rotacionit dhe menaxhimit të energjive, në një seri prej katër ndeshjesh, ndërsa objektivi mbetet marrja e maksimumit dhe lufta për vendin e parë në grup.

"Duhet të përballemi me qasjen e duhur, në ndeshje të tilla. Këto ndeshje ndihmojnë për të ndërtuar mentalitetin e një skuadre. Duhet ta marrim me qetësi këtë ndeshje. Duhet shumë respekt për San Marinon. Kjo na jep mundësi për të marrë masat e duhura për situatat që mund të ndodhin në gjashtë ndeshje. E rëndësishme është të bëjmë ndeshjen më të mirë të mundshme dhe të tregojmë ato që kemi përgatitur. Duhet lexuar situatat. Duhet bërë zgjedhjet më të mira, në varësi të mënyrës se si do të luajë kundërshtari", tha Maran.

Ndërkohë, kapiteni Berat Gjimshiti u shpreh se Shqipëria nuk duhet ta konsiderojë ndeshjen të lehtë dhe kërkoi përqendrim maksimal nga skuadra. Ai theksoi se kuqezinjtë synojnë vendin e parë në grup.

"Përqendrimi duhet të jetë në çdo ndeshje 100 për qind. Nuk duhet të konsiderojmë asnjë kundërshtar të lehtë, por duhet të japim maksimumin. Kishim një periudhë jo të mirë, por besoj se kthesa për ne ishte sfida ndaj Bjellorusisë, ku arritëm të fitojmë 2-0. Ne duam vendin e parë në grup dhe për këtë synim luftojmë. Duhet të hyjmë në fushën e blertë me mentalitetin e duhur, besoj se do ia dalim të gjithë bashkë. Edhe ata që vijnë nga pankina janë shumë të rëndësishëm nesër", tha ai.

Gjimshiti shtoi se rezultati i ndeshjes do të varet edhe nga mënyra se si Shqipëria do ta përballojë sfidën, duke vënë theksin te agresiviteti dhe cilësia e skuadrës.

"Futemi në fushë me mentalitetin e duhur. Të jemi gati 100%. Varet si do luajë San Marino, por edhe ne duam të jemi të fortë. Me seriozitetin dhe kualitetin që kemi, do ia dalim

LAJMI I FUNDIT

20:55 **Nata e 13-të e protestës "Jo në emrin tim", qytetarët mbledhen sërish në Prishtinë**

20:39 **Google teston përdorimin e inteligjencës artificiale në hapësirë**

20:26 **Videoja e Trumpit zemëron opozitën, keqpërdorim i parave publike apo mesazh patriotik? (VIDEO)**

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN Britania përgatitet për një ndalim të mundshëm të eksporteve amerikane të naftës

20:16 **Apple duhet të paguajë 5.7 miliardë dollarë, akuzohet se përdori teknologjinë e një firme tjetër**

20:13 **Alarm për bombë në Harvard, evakuohen studentët dhe stafi**

TESTIM

por eunë me shume si do luajme ne. Me agresivitetin dhe kualitetin qe kemi, do ta damin bashkë. Duhet 11 lojtarë në fushë, ata nga pankina do jenë shumë të rëndësishëm nesër. Kjo duhet të jetë forca jonë nesër”, tha ai.

Për sfidën me San Marinon, Maran pritet të bëjë disa ndryshime në formacion. I sigurt duket debutimi i Samuel Sinës, i cili ishte një nga risitë e trajnerit italian në listën e Ligës së Kombeve. 19-vjeçari pritet të aktivizohet në prapavijë, në vend të Hysajt, ndërsa Maran e kishte paralajmëruar më herët se Sina mund të luajë në krahun e djathtë.

Stavro Pilo dhe Ylber Ramadani pritet të pushojnë për këtë takim, për shkak të ndëshkimit ndaj Bjellorusisë, që u rrezikon sfidën me Finlandën. Në vend të Pilos pritet të luajë Mitaj, ndërsa Shehu pritet të aktivizohet në vendin e Ramadanit.

Ndryshime të tjera priten edhe në sulm, me Taulant Seferin dhe Arbër Hoxhën që pritet ta nisin ndeshjen nga stoli. Në vendet e tyre pritet të aktivizohen Mehmeti dhe Uzuni. Nga formacioni që luajti ndaj Bjellorusisë, si titullarë pritet të mbeten portieri Berisha, Ismajli, Gjimshiti, Asllani, Muçi dhe Manaj.

Shqipëria do të kërkojë kështu fitoren në transfertën ndaj San Marinos, me synimin për të vijuar rrugëtimin në Ligën e Kombeve dhe garën për vendin e parë në grup.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | EVROPA | LAJMI I FUNDIT

Alarm për bombë në Harvard, evakuohen studentët dhe stafi

Universiteti i Harvardit lëshoi një alarm emergjence për studentët dhe stafin të hënën në mëngjes, pas një kërcënimi me bombë në Sallën Memoriale. Në njoftimin...

20:13 | 28/09/2026

BOTA | LAJMI I FUNDIT | VIDEO

Sulm ajror në një treg në Myanmar, 33 të vrarë dhe 36 të plagosur (VIDEO)

Një sulm ajror ushtarak në një treg në perëndim të Myanmarit ka vrarë 33 persona dhe ka plagosur 36 të tjerë. Sulmi ndodhi të dielën...

20:05 | 28/09/2026

BOTA | LAJMI I FUNDIT

Thirrja për masa kundër Ebolës i kushtoi jetën, politikani rrihet për vdekje në Kongo

Një zyrtar i lartë i partisë në pushtet në Republikën Demokratike të Kongos është rrahur për vdekje pasi mori pjesë në një emision radiofonik ku...

19:47 | 28/09/2026

TEMA

Vendi

Relatimi

SHËRBIME

Live

Relatimi fundit

KOMPANIA

Rreth Euronews

Kontakti me redaksinë

na joni
Bota
Video

Lajmi tani
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

Kushtet e personimit
Politika e cookie
Kontaktimi
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.